



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 31 tetor 2016
Nr. ref.:RK992/16

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI12/16

Parashtrues

IMING D.O.O.

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, AC-I-15-0145-A0001, të 1 tetorit 2015

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërzhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është Kompania IMING D.O.O. (në tekstin e mëtejshëm: IMING) me seli në Stobec, Republika e Kroacisë (në tekstin e mëtejshëm: parashtruesi i kërkesës). Parashtruesin e kërkesës e përfaqësojnë avokatët Bejtush Isufi dhe Linn Slattengren, nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, AC-I-15-0145-A0001 (në tekstin e mëtejme: Kolegji i Apelit) të 1 tetorit 2015, i cili i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 27 tetor 2015.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar, me të cilin pretendohet të jenë shkelur të drejtat e parashtruesit të kërkesës të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], dhe nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), si dhe të drejtat e garantuara me nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ), dhe nenin 1 [Mbrojtja e pronës] të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenet 113.7 dhe 21.4 të Kushtetutës dhe nenet 29 dhe 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 18 janar 2016, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 12 shkurt 2016, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Bekim Sejdiu dhe Selvete Gërxhaliu-Krasniqi.
7. Më 29 shkurt 2016, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: DHPGJS) dhe Agjencisë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: AKP).
8. Më 13 shtator 2016, Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović gjyqtar kryesues në Kolegjin shqyrtues për ta zëvendësuar gjyqtarin Robert Carolan.
9. Më 14 shtator 2016, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Në një datë të pacaktuar, Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (në tekstin e mëtejshëm: AKM) ka iniciuar *spin off* special për shitjen e aksioneve të kompanisë Miniera Mim Golesh (në tekstin e mëtejshëm: MMG).
11. Pas përfundimit të procesit të tenderimit, parashtruesi i kërkesës është zgjedhur nga AKM-ja si kompani e cila i ka plotësuar të gjitha kriteret e kërkuara me dokumentacionin tenderues.
12. Më 11 dhjetor 2007, AKM-ja ka lidhur kontratë me parashtruesin e kërkesës për shitjen e aksioneve të MMG-së.
13. Kontrata e lidhur ndërmjet AKM-së dhe parashtruesit të kërkesës e detyroi parashtruesin për t'i plotësuar kushtet e përcaktuara me "Marrëveshjen për Zotime". Këto kërkesa përfshinin detyrimin për të bërë investime të caktuara financiare në MMG dhe për të punësuar një numër të caktuar të punëtorëve në një periudhë të caktuar kohore. Dështimi për t'i përmbushur këto kërkesa, në bazë të kontratës së nënshkruar, mund të çonte në tërheqjen nga AKM-ja të aksioneve të shitura parashtruesit.
14. Më 21 dhjetor 2011, Bordi i Drejtorëve i AKP-së, pasardhësi ligjor i AKM-së, konstatoi se parashtruesi i kërkesës nuk ka vepruar në pajtim të plotë me detyrimet për punësimin dhe investimin që ishin të përcaktuara në "Marrëveshjen për Zotime". Për këtë arsye, Bordi i Drejtorëve i AKP-së vendosi njëzëri të bëjë kthimin e aksioneve dhe në këtë mënyrë t'i tërheqë të gjitha aksionet e blera nga parashtruesi i kërkesës. Në vendim theksohet:

"Ky vendim mund të mos ekzekutohet pas datës 15 Mars 2012, në qoftë se gjatë kësaj kohe Komisioni dhe blerësi i Ndërmarrjes së Re "MIM Golesh" arrijnë marrëveshje të kënaqshme e cila do të rezultojë me propozimin e Komisionit Bordit të Drejtorëve për vazhdimin e kontratës duke u bazuar në garancionet e nevojshme të siguruara nga ana e blerësit".
15. Më 15 mars 2012, Bordi i Drejtorëve i AKP-së nxori vendimin me të cilin e pezulloi ekzekutimin e vendimit të tij të 21 dhjetorit 2011. Në arsyetim theksohet:

*"1) Pezullohet ekzekutimi i vendimit të Bordit të Agjencisë i dhjetorit 2011 për tërheqje të aksioneve.
2) Bordi aprovon rekomandimin e Komisionit për lejim të hipotekimit të asetëve të ndërmarrjes. Hipotekimi duhet dhe mund të bëhet nën kushte të caktuara, njëra prej të cilave është përfshirja e AKP-së si palë në marrëveshjen për hipotekë. Të drejtat dhe kufizimet tjera të ndërlidhura me hipotekimin e asetëve do të ju bëhen të njohura nga Agjencia ndarazi nga ky njoftim, brenda një kohë të shkurtër".*
16. Më 31 tetor 2013, Bordi i Drejtorëve i AKP-së në bazë të shqyrtimit të raportit të menaxhmentit të AKP-së në lidhje me kontratën e kompanisë MMG, nxori vendimin nr. ref. BD-58/11 me të cilin "vendimi i Bordit të Drejtorëve në lidhje me zgjatjen e afatit të Marrëveshjes së Zotimeve të 11 dhjetorit 2007, zgjatet

edhe për 2 vite pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Zotimeve të ndryshuar. Në rast se blerësi (parashtruesi) refuzon nënshkrimin e Marrëveshjes së Zotimeve me kushtet e ndryshuara atëherë të zbatohet Vendimi i Bordit të Drejtorëve i dhjetorit 2011 për kthimin e aksioneve”.

17. Më 31 gusht 2014, Bordi i Drejtorëve i AKP-së në bazë të raportit të menaxhmentit për “investimet“ *spin off* konkludoi se blerësi (parashtruesi i kërkesës) nuk i kishte plotësuar kushtet nga neni 6.2 i “Marrëveshjes për Zotime”, të cilën ai e kishte nënshkruar me AKP-në. Për këtë arsye e nxori vendimin nr. Ref. BD-69/35, me të cilin:

“a) Aprovohet ekzekutimi i vendimit të Bordit të AKP-së i dhjetorit 2011, për tërheqje të aksioneve për Ndërmarrjen e Re MIM Golesh.

b) Udhëzohet Menaxhmenti i AKP-së të veproj sipas procedurave dhe në bazë të Ligjit në fuqi për kthimin e aksioneve të Ndërmarrjes së Re MIM Golesh.”

18. Në të njëjtën ditë, Bordi i Drejtorëve i AKP-së nxori vendimin nr. Ref. BD-69/36 me të cilin kompania “MIM Golesh” vendoset nën administrimin e drejtpërdrejtë të AKP-së sipas nenit 15.2, pika 2.5 në lidhje me nenin 6, paragrafi 1.5 të Ligjit për AKP-në, nr. 04/L-034.

19. Më 30 tetor 2014, parashtruesi dorëzoi kërkesë dhe padi në Kolegjin e Specializuar të DHPGJS-së. Parashtruesi në kërkesë ka kërkuar pezullimin e përkohshëm të ekzekutimit të vendimit të AKP-së Nr. BD-69/35, të 31 gushtit 2014 për tërheqjen e aksioneve dhe vendimit Nr. BD 69/36, të 31 gushtit 2014 në lidhje me vendosjen e MIM “Golesh” nën administrimin e AKP-së, deri në marrjen e vendimit përfundimtar mbi meritat e padisë.

20. Parashtruesi i kërkesës në padinë e Kolegjit të Specializuar të DHPGJS theksoi se *“e konteston vlefshmërinë e vendimit, i cili u mor një të diel, në ditën e fundit të mandatit të disa anëtarëve të bordit. Ai po ashtu konteston se vendimi është i padrejtë sepse në vendimmarrje kanë marrë pjesë pesë anëtarë, vetëm katër prej tyre kanë aprovuar tërheqjen e aksioneve”.* Gjithashtu, parashtruesi i kërkesës theksoi që *“i ka përmbushur të gjitha detyrimet kontraktuale për investimin e detyrueshëm”.*

21. Më 25 maj 2015, Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së nxori Aktgjykimin C-I-14-0022 me të cilin kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimeve dhe padinë e parashtruesit i refuzoi si të pabazuara. Në arsyetimin e pretendimeve të parashtruesit, Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së *inter alia* theksoi:

“Vendimet e atakuara të marra nga AKP-ja janë të bazuara në ligj dhe nuk shkelin të drejtat e paditësit.

Vendimet e AKP-së për të tërhequr aksionet dhe rimarrë kontrollin mbi kompaninë janë lëshuar në përputhje me rregullat procedurale në fuqi.

Fakti se bordi ka marrë vendim një ditë të diel është i parëndësishëm. Bordi nuk është i obliguar të punojë të dielën, por asnjë dispozitë ligjore nuk e ndalon bordin e AKP-së për ta bërë këtë.

Po ashtu nuk është thelbësore për rastin që disa anëtarë të bordit kanë punuar në ditën e fundit të mandatit të tyre. Nuk ka asnjë dispozitë që përkufizon kompetencat e një anëtari të bordit që është afër përfundimit të mandatit të saj apo të tij. Prandaj, edhe në ditën e fundit të mandatit, çdo anëtar i bordit ka kapacitet të plotë për të ushtruar këtë funksion.

Bordi ka vepruar duke respektuar kuorumin prej më së paku pesë anëtarëve të pranishëm të bordit (neni 14.4 e Ligjit për AKP-në)”.

22. Për sa i përket pretendimeve të parashtruesit të kërkesës lidhur me përmbushjen e detyrimeve kontraktuale që kanë të bëjnë me investimet, Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së ka theksuar:

“Paditësi ka bërë shkelje të rëndë të detyrimit të tij në punësimin e personelit me orar të plotë ... Të gjitha obligimet (detyrimet) e një kontrate duhet të respektohen, dhe nëse tejkalohej njëri prej obligimeve, dështimi nuk mund të kompensohet me një obligim tjetër. Për atë arsye, mospërmbushja e obligimit kontraktual në punësimin e personelit në mënyrë të mjaftueshme e mbështet vendimin për tërheqjen e aksioneve. Prandaj, pyetja nëse paditësi ka investuar para të mjaftueshme apo jo për të respektuar obligimet kontraktuale është e parëndësishme për vendimin në rastin në fjalë. Prandaj, gjykata nuk e gjeti të arsyeshme të ftojë një ekspert për të vlerësuar vlerën e investimeve të bëra.

Si pasojë e tërheqjes së aksionave, vendimi për të marrë kontrollin mbi kompaninë ishte e domosdoshme për të mbrojtur status quo-n dhe për të mbrojtur investimet e bëra”.

23. Më 1 korrik 2015, parashtruesi i kërkesës parashtrroi ankesë në Kolegjin e Apelit kundër Aktgjykimit të Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së, të 25 majit 2015, duke pretenduar shkelje procedurale, vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimin e gabuar të së drejtës materiale në dëm të paditësit.
24. Përveç kësaj, parashtruesi i kërkesës në ankesë ka shtuar se „vendimi i kontestues i Bordit domosdo është dashtë të mirret me shumicë të kualifikuar më së paku 5 vota pro e jo siç është vepruar në rastin konkret, kur në mbledhje të Bordit kanë marrë pjesë 5 anëtarë të pranishëm të Bordit dhe vetëm 4 nga anëtarët kanë votuar për dhe një ka abstenuar... Nga kjo bazë vendimet e kontestuara të të paditurës e shkelin ligjin drejtëperdrejt, dhe i shkelin të drejtat e paditëses”.
25. Për sa i përket përmbushjes së detyrimeve kontraktuale në lidhje me investimet, parashtruesi i kërkesës theksoi: “Bordi fare nuk ka verifikuar provat e ofruara nga paditësja, se ka investuar më shumë miliona euro, e ky investim nuk vlerësohet as nga Dhoma sipas aktgjykimit kontestues me arsyetimin se paditësja nuk ka plotësuar kushtin e punësimit të punëtorëve, edhe pse punësimi ishte njëri nga kushtet, ngase kushtet kryesore të kontratës siç është

pagesa e çmimit, dhe zotimit i përmbushjes së investimeve ishin plotësuar pjesërisht, edhe pse afati i punësimit i cili ishte përmbushë pjesërisht ... Rrjedhimisht, parashtruesi ka kërkuar “që të bëhej një vlerësim i ri i shumës reale të investimeve përmes një ekspertize të re”.

26. Më 22 korrik 2015, e paditura (AKP-ja) ka paraqitur përgjigje në ankesë në Kolegjin e Apelit të DHPGJS-së në të cilin thekson se në tërësi i konteston pretendimet e parashtruesit të paraqitura në ankesë. Ajo gjithashtu theksoi se Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së i ka shqyrtuar me kujdes të gjitha provat e paraqitura nga palët në procedurë dhe pretendimet e tyre në seancën dëgjimore, dhe në këtë mënyrë palëve ndërgjyqëse u është mundësuar barazia e armëve; prandaj, pretendimi i paditësit se Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së nuk i ka shqyrtuar provat e paraqitura nuk është i bazuar në ligj.
27. Më 1 tetor 2015, Kolegji i Apelit nxori Aktgjykimin AC-I-15-0145, me të cilin e refuzoi ankesën e parashtruesit si të pabazuar, ndërsa aktgjykimin e Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së e vërtetoi në tërësi. Sa i përket pretendimeve mbi të cilat është bazuar ankesa e parashtruesit, Kolegji i Apelit i DHPGJS-së theksoi:

“Kolegji i Apelit pajtohet me konkluzionin e Kolegjit të Specializuar se nuk ishte e domosdoshme të bëhej një vlerësim i ri i shumës reale të investimeve përmes një ekspertize të re, siç kërkonte [parashtruesi i kërkesës] meqë siç ka konkluduar saktë Kolegji i Specializuar të gjitha detyrimet e marra me kontratë të blerjes së aksioneve nga ana e [parashtruesit të kërkesës] duhet të respektohen, edhe nëse ndodhë që njëri nga obligimet e marra nuk mund të përmbushet, dështimi në përmbushjen e këtij obligimi nuk mund ta kompensohet me një obligim tjetër kontraktues.

Më konkretisht, Kolegji i Apelit vlerëson se mospërmbushja e obligimit kontraktual për punësimin e personelit në numër të paraparë me Kontratën e shitjes, është bazë e mjaftueshme për të ardhur në konkluzionin se vendimet e kontestuar të Bordit të AKP-së ishin ligjore dhe në pajtim me procedurat e parapara me ligj”.

28. Sa i përket pretendimeve të parashtruesit të kërkesës në lidhje me kuorumin e Bordit të Drejtorëve të AKP-së me rastin e marrjes së vendimit të 31 gushtit 2014, Kolegji i Apelit i DHPGJS-së *inter alia* theksoi:

“Lidhur me këtë pretendim të [parashtruesit të kërkesës] Kolegji i Specializuar ka dhënë përfundime të sakta dhe në pajtim me ligjin. [Parashtruesi i kërkesës] nuk ka të drejtë në këto pretendime, pasi që në bazë të nenit 14.4 të Ligjit për AKP-në Bordi konsiderohet se ka kuorum nëse janë të pranishëm se paku 5 drejtorë, dhe së paku njëri ndër ta duhet të jetë ndërkombëtarë, ndërsa në bazë të nenit 14.6 të Ligjit për AKP-në vendimet mund të merren në Bordin e AKP-së me një shumicë të thjeshtë të anëtareve të pranishëm, gjë që në këtë rast kjo ka ndodhur. Në mbledhjen e Bordit ishin prezent 5 anëtarë, 4 vota kanë qenë pro edhe 1 abstenim kur është marrë vendimi për zbatimin e vendimit për tërheqjen e aksioneve, ndërsa 5 vota ishin pro kur është marrë vendimi për marrjen e kontrollit mbi aksionet e kompanisë nga ana e AKP-së. [Parashtruesi i kërkesës] pa të drejtë pretendon se këto vendime hyjnë në listën e vendimeve nga neni 15.2

të Ligjit të AKP-së ku kërkohet shumica e kualifikuar për marrjen e vendimeve përfshirë edhe 3 anëtar ndërkombëtarë të Bordit të AKP-së.

Kolegji i Specializuar saktë ka konkluduar se vendimet e kontestuara të AKP-së nuk hyjnë në listën e vendimeve nga neni 15.2 të Ligjit të AKP-së për të cilat kërkohet shumica e kualifikuar.

Në bazë të këtyre arsyeve, Kolegji i Apelit e refuzon ankesën e [parashtruesit të kërkesës] si të pabazuar dhe e vërteton Aktgjykimin e ankimuar të Kolegjit të Specializuar si të saktë dhe të bazuar në ligj”.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

29. Parashtruesi i kërkesës pretendon se vendimi i AKP-së për marrjen e pronësisë mbi 100% të aksioneve është në kundërshtim me nenin 46 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 1 të Protokollit 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ). Kjo procedurë paraqet eksproprihimin arbitrar dhe antikushtetues.
30. Gjithashtu, parashtruesi i kërkesës pretendon se dështimi i të gjithë mekanizmave të Shtetit, përfshirë edhe Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, për të mbrojtur të drejtat e tij pronësore, paraqet shkelje të nenit 31 të Kushtetutës së Kosovës dhe nenit 6 të KEDNJ-së. Parashtruesi i kërkesës nuk ka pasur mbrojtje efektive dhe të duhur të të drejtave të tij pronësore nga gjykata e cila nuk e ka respektuar parimin e barazisë së armëve.
31. Rrjedhimisht, parashtruesi i kërkesës i drejtohet Gjykatës me kërkesë për të vërtetuar se ka pasur shkelje të nenit 31 dhe 46 të Kushtetutës së Kosovës në lidhje me nenin 6 dhe nenin 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së, dhe për t'i shpallur të pavlefshme vendimet e Bordit Drejtues të AKP-së nr. BD -69/35 dhe nr. BD-69/36 mbi tjetërsimin e detyruar të pronësisë mbi të gjitha aksionet.
32. Në këtë drejtim, pretendimet e parashtruesit të kërkesës duhet të ndahen si më poshtë:
 - pretendimet në lidhje me shkeljen e të drejtës për gjykim të drejtë dhe
 - pretendimet në lidhje me shkeljen e mbrojtjes së pronës

Pretendimet në lidhje me shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së

33. Parashtruesi i kërkesës pretendon se për shkak të trajtimit të pabarabartë nga ana e DHPGJS-së, gjykimin përtej fushëveprimit të padisë së parashtruesit, zbatimit dhe interpretimit të Ligjit të AKP-së dhe ndërhyrjes së paligjshme në pronën e tij “[...] gjithashtu, në mënyra të ndryshme të veçanta, kanë shkelur të drejtat e tij themelore të përcaktuara me dispozitat e nenit 6 të KEDNJ-së dhe nenit 31 të Kushtetutës së Kosovës”.
34. Parashtruesi i kërkesës pretendon se ky trajtim i pabarabartë ka të bëjë me trajtimin e padrejtë gjatë procedurës në DHPGJS-së dhe se në këtë mënyrë „barazia e armëve në vetvete ka krijuar shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së, për

shkak se krijon paragjykim ndaj njërës palë, në këtë rast, ndaj parashtruesit të kërkesës”.

35. Parashtruesi i kërkesës pretendon se DHPGJS-ja kishte detyrim ligjor për t'i dhënë palëve në procedurë mundësi të barabarta për t'i paraqitur provat dhe të argumentojë rastin e tyre. Parashtruesi i kërkesës pretendon se nuk ishte lejuar të paraqesë prova plotësuese lidhur me investimet e tij financiare. Prandaj, sipas parashtruesit të kërkesës, ai nuk ka pasur gjykim të drejtë dhe të paanshëm dhe mundësi për të deklaruar në lidhje me rastin e tij.
36. Parashtruesi i kërkesës pretendon se vendimet e Bordit të Drejtorëve të AKP-së janë marrë në kundërshtim me ligjin, gjë që ai gjatë gjithë procedurës pretendoi dhe si pasojë ka pasur shkelje të nenit 31 të Kushtetutës.
37. Parashtruesi i kërkesës, më tej, pretendon që mosdhënia e mundësisë të paraqesë prova për të provuar faktet vendimtare (shumën e investimeve dhe numrin e të punësuarve), paraqet shkelje efektive të së drejtës për shqyrtim të drejtë.

Pretendimet në lidhje me shkeljen e mbrojtjes së pronës, siç garantohet me nenin 46 të Kushtetutës dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së

38. Parashtruesi i kërkesës citon praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GJEDNJ) në lidhje me çështjen e eksproprijimit dhe pretendon se aktgjykimi i kontestuar përbën shkelje “[...] të mbrojtjes që i jepet parashtruesit sipas nenit 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së dhe nenit 46 të Kushtetutës së Kosovës [...]”.
39. Në këtë drejtim, parashtruesi i kërkesës pretendon se AKP-ja, duke vepruar si agjenci e Qeverisë “[...] në mënyrë të paligjshme dhe pa proces të duhur ka shpronësuar asetet e pronës së saj pavarësisht nga të gjitha garancitë e dhëna AKP-së. Në rastin konkret, ka pasur procedurë të shpronësimit pa asnjë procedurë të përcaktuar me legjislacionin në fuqi dhe në kundërshtim me dispozitat kontraktuale të rënë dakord ndërmjet palëve”.
40. Prandaj, parashtruesi i kërkesës pretendon që “Akti i Shpronësimit, i kryer në kundërshtim me të gjitha garancitë e përmendura më lart, është arbitrar, antikushtetues, nuk i shërben interesit publik dhe është qartësisht jo proporcional. Me pak fjalë, sjellja e autoriteteve publike të përfshira në këtë shpronësim arbitrar dhe pa asnjë dëmshpërblim është një hile e madhe. Kjo është një shkelje e qartë e nenit 46 të Kushtetutës së Kosovës dhe nenit 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së. Përveç kësaj, edhe në rast se për ndonjë arsye shpronësimi konsiderohet të jetë i ligjshëm, mungesa e dëmshpërblimit adekuat e bën atë të paligjshme dhe jokushtetuese”.

**Dispozitat relevante të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit,
nr. 04/L-034**

Neni 31 [Ligji në fuqi]

1. Ky ligj mbisundon çdo dispozitë tjetër të së drejtës në Kosovë që është në kundërshtim me të. Pa paragjykim ndaj aplikimit të përgjithshëm të fjalisë së mëparshme, parashihet në mënyrë specifike që Ligji për Procedurën Administrative nuk do të vlejë:

1.1. për çfarëdo veprimi të ndërmarrë nga Agjencia sipas autorizimeve të këtij ligji lidhur me privatizimin, likuidimin, shitjen, transferimin, restrukturimin, riorganizimin apo mënyrat tjera të zgjidhjes së një ndërmarrje, korporate apo asetit, dhe

1.2. për trajtimin dhe përcaktimin nga Agjencia të autoritetit të likuidimit të çfarëdo pretendimi apo interesi të bërë apo të pohuar nga cilitdo person si kreditor apo pronar i supozuar.

2. Me këtë ligj shfuqizohet Ligji nr. 03/L-067, "për Agjencinë Kosovare të Privatizimit".

3. Agjencia merr përsipër të gjitha asetet dhe detyrimet të cilat ajo ose paraardhësja e saj i ka mbajtur, fituar apo shkaktuar sipas Rregullores së UNMIK-ut 2002/12. Bordi dhe menaxhmenti i Agjencisë i përmbushin të gjitha përgjegjësitë e cilitdo Bordi ose menaxhmenti paraardhës të emëruar sipas Rregullores së UNMIK-ut 2002/12.

4. Pa paragjykim ndaj fushëveprimit të përgjithshëm të paragrafit të mëparshëm apo paragrafit 2 të nenit 3 të këtij ligji, parashihet në mënyrë specifike që Agjencia është trashëgimtarja ligjore dhe ekskluzive e cilësdo apo të gjitha të drejtave dhe obligimeve të AKM-së që janë specifikuar apo kanë dalë në lidhje me ndonjë kontratë që është ekzekutuar më parë nga AKM-ja dhe një apo më shumë palë të treta që si objekt kryesor të tyre kanë pasur menaxhimin, operimin, shitjen, transferimin, likuidimin apo ndonjë mënyrë tjetër të disponimit me ndërmarrjen, korporatën, asetin apo çfarëdo interesi në cilëndo nga këto. Çdo referim i kontratave të tilla në AKM do të interpretohet në mënyrë përfundimtare se nënkupton Agjencinë. Çdo referim i kontratave të tilla në Përfaqësuesin Special të Sekretarit të Përgjithshëm do të interpretohet në mënyrë përfundimtare se nënkupton Bordin e Agjencisë. Nëse kontrata përmban një apo më tepër dispozita që specifikojnë që kontrata bazohet në ndonjë ligj të ndonjë shteti të huaj:

4.1. as ajo dispozitë e as ai ligj i shtetit të huaj nuk përdoret, interpretohet apo zbatohet në mënyrë të tillë që të shmangë apo pakësojë kriteret e paraqitura më lart në këtë paragraf, dhe

4.2. ky paragraf nuk interpretohet si paragraf që e bën të vlefshëm apo të pavlefshëm, në tërësi apo pjesërisht, në çfarëdo mënyrë, zgjedhjen e ligjit të specifikuar në atë dispozitë; vlefshmëria apo pavlefshmëria përcaktohet në pajtim me rregullat e aplikueshme të së drejtës ndërkombëtare private.

5. Drejtorët e Bordit të emëruar nga PCN sipas nenit 12, paragrafi 3. do të vazhdojnë të qëndrojnë në pozitat e tyre edhe pas përfundimit të mandatit të PCN dhe do të kompensohen nga të ardhurat e dedikuara të AKP-së përveç nëse vendoset ndryshe nga PCN para përfundimit të mandatit të tij.

Pranueshmëria e kërkesës

41. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe Rregullore të punës.
42. Gjithashtu, Gjykata thekson se, në pajtim me nenin 21.4 të Kushtetutës, i cili përcakton se *“Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejné edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme”*, parashtruesi i kërkesës ka të drejtë të paraqesë ankesë kushtetuese, duke iu referuar të drejtave themelore që zbatohen për individët dhe subjektet juridike (shih, *mutatis mutandis*, Aktvendimi i 27 janarit 2010, kërkesa KI41/09, AAB-RIINVEST Universiteti SHPK, Prishtinë kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës).
43. Gjykata merr parasysh nenin 48 të Ligjit, i cili përcakton:
- “Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.*
44. Gjykata i referohet rregullit 36 (1) dhe (2) të Rregullores së punës, i cili parasheh:
- “(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:*
- (d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.*
- (2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:*
- (a) kërkesa nuk arsyetohet prima facie, ose*
- (b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese, ose*
- (c) Gjykata gjen që parashtruesi nuk është subjekt i ndonjë shkeljeje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë; ose*
- (d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.*

Pretendimet në lidhje me shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës dhe të nenit 6.1 të KEDNJ-së

45. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se me Aktgjykimin e Kolegjit të Apelit AC-I-15-0145-A0001 janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6.1 të KEDNJ-së.
46. Gjykata rikujton nenin 31 të Kushtetutës, i cili përcakton:

“1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.

*2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.
[...].”*

47. Gjykata rikujton edhe nenin 6.1 të KEDNJ-s, i cili përcakton:

*“1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohet shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtojte interesat e drejtësisë.
[...].”*

48. Siç u theksua më lart, parashtruesi i kërkesës pretendon se trajtimi i pabarabartë nga DHPGJS-ja, gjykimi përtej fushëveprimit të padisë së parashtruesit të kërkesës, zbatimi dhe interpretimi i Ligjit për AKP-në dhe ndërhyrja e paligjshme në pronën e tij, kanë shkelur në mënyra të ndryshme të drejtat e tij të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës dhe me nenin 6 të KEDNJ-së.
49. Së pari, parashtruesi i kërkesës pretendon se DHPGJS-ja kishte detyrim ligjor që t'u ofroj palëve në procedurë mundësi të barabarta për të paraqitur dëshmi dhe për ta argumentuar rastin e tyre. Parashtruesi i kërkesës pretendon se nuk ishte lejuar të paraqesë prova plotësuese lidhur me investimet e tij financiare. Sipas parashtruesit të kërkesës, atij nuk i ishte ofruar një gjykim i drejtë dhe i paanshëm dhe një mundësi për ta paraqitur rastin e tij.
50. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës nuk ka paraqitur ndonjë dëshmi apo argument se si dhe pse ai ishte trajtuar në mënyrë të pabarabartë dhe në çfarë mënyre atij nuk i ishte ofruar mundësi e arsyeshme për të paraqitur dëshmi dhe për ta paraqitur rastin e tij para DHPGJS-së.
51. Gjykata përsërit se pakënaqësia e parashtruesit me vendimin nuk është e mjaftueshme që parashtruesi të ngre një pretendim bindës për shkelje kushtetuese të së drejtës për gjykim të drejtë. Kur pretendon shkeljet kushtetuese, parashtruesi duhet të paraqesë argumente bindëse dhe të padiskutueshme për të mbështetur pretendimet e tij, në mënyrë që kërkesa të jetë e bazuar (shih, Aktvendimin për papranueshmëri, të 30 qershorit 2014, nr. KI198/13, Agjencia Kosovare e Privatizimit).

52. Gjykata konsideron se Kolegji i Specializuar dhe Kolegji i Apelit të DHPGJS-së i kanë kryer procedurat në mënyrë të drejtë dhe i kanë arsyetuar vendimet e tyre mbi bazën e padisë dhe ankesave të parashtruesit, gjë që pikërisht mund të shihet në aktgjykimet e arsyetuara.
53. Në lidhje me këtë, Gjykata gjithashtu vëren se Kolegji i Specializuar dhe Kolegji i Apelit të DHPGJS-së i kanë arsyetuar vendimet e tyre bazuar në prova edhe në argumentet e ofruara nga parashtruesi i kërkesës, në cilësi të paditësit dhe gjithashtu në bazë të provave dhe përgjigjeve ndaj padisë së parashtruar nga AKP-ja, në cilësinë e të paditurës. Bazuar në atë që u tha më lart, fakti që edhe parashtruesit të kërkesës e edhe AKP-ja, që të dyja palë në procedurë në DHPGJS, *“u është dhënë mundësia që të jenë në dijeni dhe të komentojnë të gjitha provat e sjella ose vërtetimet e paraqitura me qëllim të ndikimit në vendimin e gjykatës”* tregon se Kolegji i Specializuar dhe Kolegji i Apelit i DHPGJS-së i kanë arsyetuar dhe i kanë nxjerrë vendimet e tyre në përputhje me parimet e garantuara me të drejtën për një gjykim kundërshtues (Shih rastin *Vermeulen kundër Belgjikës*, GJEDNJ, nr. 19075/91, Aktgjykim i 20 shkurtit 1996).
54. Së dyti, parashtruesi i kërkesës pretendon se zbatimi selektiv dhe interpretimi i disa dispozitave ligjore të Ligjit për AKP-nga Bordi i Drejtorëve i AKP-së lidhur me kuorumin ka ndikuar në legjitimitetin e vet Bordit, dhe, për këtë arsye, edhe në legjitimitetin e vendimeve të marra. Prandaj, vendimet e Bordit të Drejtorëve të AKP-së, sipas pretendimeve të parashtruesit, ishin joligjore si *ultra vires*.
55. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se Kolegji i Specializuar dhe Kolegji i Apelit të DHPGJS-së i kishin trajtuar pretendimet e parashtruesit në lidhje me legjitimitetin e përbërjes së Bordit të Drejtorëve të AKP-së, si dhe në lidhje me legjitimitetin e vendimeve të marra për të cilat parashtruesi konsideron se janë joligjore si *ultra vires*, ku dhe konkluduan:
- “Vendimi për tërheqjen e aksioneve u mor nga një shumicë prej katër nga gjithsej pesë votat, që është në përputhje me kërkesën e shumicës së thjeshtë (neni 14.6 e Ligjit për AKP-në). [Parashtruesi i kërkesës] thirret në atë se kjo nuk arriti të përbush standardin shumicë të kualifikuar. Në fakt, neni 14.7 e Ligjit për AKP-në kërkon pesë vota pozitive për vendimet që kërkojnë një shumicë të kualifikuar. Neni 15.2 të Ligjit për AKP-në është i aplikueshëm edhe për rastet e rimarrjes së kontrollit (për dallim nga marrja fillestare e kontrollit) të një ndërmarrjeje”.*
56. Në këtë drejtim, Gjykata shton se vet shkelja e nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6.1 të KEDNJ-së nuk varet nga siguria e një rezultati të favorshëm të procedurës për parashtruesin. Argumentet e parashtruesit të kërkesës përkitazi me atë se cili ligj është dashur të aplikohet nga gjykatat e rregullta dhe se si është dashur të interpretohet ai ligj, janë jashtë fushëveprimit të juridiksionit të Gjykatës, përveç nëse me rastin përzgjedhjes së asaj se cili ligj do të aplikohet dhe si do të interpretohet ai ligj, gjykatat e rregullta kanë qenë qartazi arbitrare.
57. Kjo do të thotë se kur ndërtohet një rast para Gjykatës Kushtetuese nuk është e mjaftueshme që parashtruesi thjesht të pretendojë shkelje të nenit 31 të

Kushtetutës dhe nenit 6.1 të KEDNJ-së, në bazë të faktit se gjykatat nuk kanë pranuar pretendimet e parashtruesit si të bazuara lidhur me zbatimin dhe interpretimin e gabuar të dispozitave relevante ligjore, dhe kryesisht kur ankesat nuk ishin të favorshme për parashtruesin.

58. Në këtë drejtim, duhet të merret parasysh, sepse ky është burimi i shumë keqkuptimeve nga ana e parashtrueseve të kërkesës, që “drejtësia” që kërkohet me nenin 31 nuk është drejtësi “substanciale” (nacion që ndodhet në kufijtë e së drejtës dhe të etikës dhe që vetëm gjyqtari i fakteve mund ta zbatojë), por drejtësi “procedurale”. Në terma praktik kjo shprehet me procedurë kontradiktore ku palët dëgjohen dhe vendosen në të njëjtat kushte para gjykatës (Shih GJEDNJ, Vendim i 6 korrikut 2010, *Star Cate–Epilekta Gevmata dhe të tjerë kundër Greqisë*, nr. 54111/07).
59. Sa i përket vet zbatimit të Ligjit për AKP-në nga të dy shkallët të DHPGJS-së, Gjykata i referohet jurisprudencës së saj, ku ka konkluduar së në kontekstin e sundimit të ligjit dhe në bazë të nenit 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] të Kushtetutës: “[...] Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme, si pjese e Gjyqësorit të Kosovës, ka obligim kushtetues të zbatoj ligjet e miratuara nga Kuvendi i Kosovës“ (shih, rastin KI25/10, parashtruesi i kërkesës: *Agjencia Kosovare e Privatizimit*, Aktgjykimi i 30 marsit 2011, paragrafi 56).

Pretendimet në lidhje me shkeljen e mbrojtjes së pronës, siç garantohet me nenin 46 të Kushtetutës dhe me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së

60. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendon se aktgjykimet e kontestuara përbëjnë shkelje të mbrojtjes së pronës, të garantuar me nenin 46 të Kushtetutës dhe me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.
61. Gjykata vëren se parashtruesi pretendon se e drejta e tij për gëzim paqësor të pronës i është shkelur nga ana e AKP-së dhe është shkelur me vendimet e Dhomës së Posaçme, si dhe kjo procedurë e AKP-së dhe e Dhomës së Posaçme shkel të drejtat të mbrojtura me nenin 46 të Kushtetutës dhe nenin 1 të Protokollit të 1 të KEDNJ-së.
62. Gjykata rikujton nenin 46 të Kushtetutës, i cili përcakton:

“1. E drejta e pronës është e garantuar.

2. Shfrytëzimi i pronës rregullohet me ligj, në pajtim me interesin publik.

3. Askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona. Republika e Kosovës ose autoriteti publik i Republikës së Kosovës mund të bëjë ekspropriimin e pronës nëse ky ekspropriim është i autorizuar me ligj, është i nevojshëm ose i përshtatshëm për arritjen e qëllimit publik ose për krahejen e interesit publik, dhe pasohet me sigurimin e kompensimit të menjëhershëm dhe adekuat për personin ose personat prona e të cilave ekspropriohehet.

4. Kontestet që lindin nga akti i Republikës së Kosovës ose autoritetit publik të Republikës së Kosovës për të cilat pretendohet se përbëjnë ekspropriimin, do të zgjidhen nga gjykata kompetente.

5. Prona intelektuale mbrohet me ligj”.

63. Përveç kësaj, Gjykata rikujton nenin 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore] të Kushtetutës, i cili përcakton:

“1. Të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, mund të kufizohen vetëm me ligj.

2. Të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, mund të kufizohen vetëm deri në atë masë sa është e domosdoshme që, në një shoqëri të hapur dhe demokratike, të përmbushet qëllimi për të cilin lejohet kufizimi.

3. Kufizimet e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, nuk mund të bëhen për qëllime të tjera, përveç atyre për të cilat janë përcaktuar.

4. Me rastin e kufizimit të të drejtave të njeriut dhe interpretimit të atyre kufizimeve, të gjitha institucionet e pushtetit publik, dhe sidomos gjykatat, e kanë për detyrë t'i kushtojnë kujdes esencës së të drejtës që kufizohet, rëndësisë së qëllimit të kufizimit, natyrës dhe vëllimit të kufizimit, raportit midis kufizimit dhe qëllimit që synohet të arrihet, si dhe të shqyrtojnë mundësinë e realizimit të atij qëllimi me kufizim më të vogël. 5. Kufizimi i të drejtave dhe lirive të garantuara me këtë Kushtetutë, nuk bën të mohojë kurrësi esencën e së drejtës së garantuar”.

64. Gjykata rikujton edhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, i cili përcakton:

“Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.

Megjithatë, dispozitat e mëparshme nuk çenojnë të drejtën e Shteteve për të zbatuar ligje, që ato i çmojnë të nevojshme për të rregulluar përdorimin e pasurive në përputhje me interesin e përgjithshëm ose për të siguruar pagimin e taksave ose të kontributeve ose të gjobave të tjera.”

65. Në rastin konkret, Gjykata vëren se humbja e pronës së parashtruesit të kërkesës, përkatësisht aksioneve në kompaninë minerare dhe e pasurisë themelore të përfshirë, është bazuar në autorizimin e përcaktuar nga AKP-ja dhe në kushtet e një kontrate të veçantë të spin-off-it.

66. Gjykata vëren se Dhoma e Posaçme sugjeron se parashtruesi ka mundur të iniciojë procedurë gjyqësore për të kërkuar të drejtën e kompensimit për dëmet lidhur me investimet e humbura që i janë bërë. Gjykata vëren se Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së e ka bërë këtë të qartë në vendimin e tij të 27 majit 2015 (Aktgjykimi C-I-14-0022).

“[...] tërheqja e aksioneve nuk do të thotë se paditësi do t'i humb të gjitha investimet e tij, dhe ai ka gjasa të këtë të drejtën për dëmshpërblim edhe pse ka mundësi që të humb ca para...”

67. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës ishte i privuar nga aksionet e tij dhe asetete fikse në kompaninë minerare dhe se kjo humbje ishte për shkak të veprimeve të AKP-së që të rikthej aksionet dhe asetet e kompanisë. Ky rikthim i pasurisë ishte bërë për të siguruar kthim adekuat dhe mbrojtje të aseteteve të ndërmarrjes shoqërore, që ishin asete publike. Si i tillë, kthimi i aksioneve dhe aseteteve të kompanisë minerare shërben për të mbrojtur interesin publik. Në këtë rast, parashtruesi i kërkesës ishte plotësisht i vetëdijshëm për termat dhe kushtet e lidhura me blerjen e aksioneve, siç ceket në kontratën speciale *spin-off*, të cilën parashtruesi e kishte nënshkruar.
68. Përveç kësaj, parashtruesit të kërkesës i janë dhënë disa mundësi për të respektuar obligimet për të investuar dhe të punësuar një numër të caktuar të punëtorëve siç ishte e përcaktuar në kontratën *spin-off*. Sipas vendimeve të Dhomës së Posaçme, si në shkallën e parë ashtu dhe në shkallën e dytë, parashtruesi nuk ka vepruar në përputhje të plotë me këto detyrime kontraktuale. Gjykata rikujton se, në vendimin e 27 majit 2015 (Aktgjykimin C-I-14-0022), Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së ka theksuar:
- “Vendimi i AKP-së për të tërhequr aksionet nuk ishte joproporcional. Obligimi për të punësuar ka qenë një obligim thelbësor dhe shkelja e këtij obligimi ishte serioze, duke lënë një numër të madh të familjeve pa të ardhura [...]”.*
69. Në këto rrethana, Gjykata konstaton se procedura e AKP-së për të marrë masa dhe për të kthyer aksionet dhe pronën e kompanisë minerare ishte e justifikueshme dhe proporcionale me arritjen e qëllimit legjitim të mbrojtjes së interesit publik, në pajtim me nenin 55 të Kushtetutës dhe nenin 1 të Protokollit të 1 të KEDNJ-së.
70. Gjykata gjithashtu konstatoi se procedurat në DHPGJS-së nuk kanë qenë të padrejta apo arbitrare (shih, rastin *Shub kundër Lituanisë*, nr. 17064/06, GJEDNJ, Vendimi i 30 qershorit 2009).
71. Në përfundim, Gjykata gjen se parashtruesi i kërkesës nuk ka paraqitur ndonjë argument bindës për të provuar se shkeljet e pretenduara janë shkelje kushtetuese.
72. Si përmbledhje, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk i ka mbështetur të gjitha pretendimet e tij, e as nuk ka dorëzuar *prima facie* dëshmi që tregon shkeljen e të drejtave të tij të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ (shih, rastin nr. KI19/14 dhe KI21/14, parashtruesi i kërkesës: *Tafil Qorri dhe Mehdi Syla*, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, vlerësim i kushtetutshmërisë së vendimit CA. nr. 2129/2013 të Gjykatës së Apelit të Kosovës, të 5 dhjetorit 2013 dhe vendimit CA. nr. 1947/2013 të Gjykatës së Apelit të Kosovës, të 5 dhjetorit 2013).
73. Gjykata konsideron se kërkesa e parashtruesit nuk i plotëson kriteret e përcaktuara me Kushtetutë, të parashikuara më tej me Ligj dhe të specifikuara me Rregulloren e punës.

74. Rrjedhimisht, kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe duhet të deklarohet e papranueshme në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) (d) dhe (2) (a) (b) (c) dhe (d) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) (d), (2) (a) (b) (c) dhe (d) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 15 shtator 2016, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.


Gjyqtarja raportuese



Snezhana Botusharova



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Arta Rama-Hajrizi